



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 140, datë 28.10.2021

PËR
DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA
FONDI PYJOR KOMBËTAR PËR KOMPLEKSIN TURISTIK REZIDENCIAL DHE
HOTELIER LURA – 5, PËR SHOQËRINË LURA SHPK

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.57/2020 "Për pyjet", Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 26.01.2017 “Per mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar”, VKM-së nr. 591/2018, VKM nr. 1353 datë 10.10.2008 "Per përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar, VKM nr. 1374 datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor" i ndryshuar, shkresës së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit Nr. 5882/1 Prot, datë 31.08.2021 dhe Nr. 5883/1 Prot, datë 12.10.2021 "Për dhënie dakordësie për heqjen nga fondi pyjor" si edhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar për kompleksin turistik rezidencial dhe hotelier Lura – 5, për Shoqërinë Lura shpk:

Faza 1, Sipërfaqja që zë struktura është 2979.93 m² e cila shtrihet në ngastrat 66 C në Ekonominë pyjore Rotull, Durrës.

Faza 2, Sipërfaqja që zë struktura është 7764.59 m² e cila shtrihet në ngastrat 66 B në Ekonominë pyjore Rotull, Durrës.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 868/prot.
29

Durrës, më 04.11.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS** ✓



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.140 datë 28.10.2021 “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtarë për kompleksin turistik rezidencial dhe Hotelier Lura -5, për shoqërinë Lura Shpk ”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

